



## **Procesverbal 9/2024**

I mbajtur në mbledhjen e IX-të të Komitetit për Komunitete, në Kryesimin e Osman Eminit - Kryesues i Komitetit për komunitete, mbledhja u mbajt me datën **25.09.2024** në ora **09.00**, në zyrën e takimeve te Kryetari i komunës.

**Rendi i ditës:**

- 1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e Komitetit për Komunitete;**
- 2. Miratimi i rendit të ditës;**
- 3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes të kaluar të Komitetit për Komunitete;**
- 4. Analizim i Draft Planit të Veprimit për Implementimin e Strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve Ashkali dhe Rom nga Komiteti për Komunitete, sygjerime dhe rekomandime për përgjegjësit e këtij draft dokumenti;**
- 5. Takimi nga Komiteti për Komunitete me Kryesuesin e kuvendit, sektorin e financave, zyrën ligjore dhe akter të tjerë lidhur me mëditjen e anëtarëve jo asambleist të Komitetit për Komunitete dhe**
- 6. Të ndryshme.**

### **Pika 1**

**Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – Konfirmoi pjesëmarrjen në mbledhje; prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për komunitete;**

### **Pika 2**

**Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini – U Miratua rendi i ditës pa ndonjë vërejtje;**

### Pika 3

**Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini** – Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua, me ndryshim që të vendosen diskutimet me emrat e anëtarëve të cilët diskutojnë..

### Pika 4

**Kryesuesi i Komitetit për komunitete Osman Emini** – Njofton për dokumentin e Planit lokal të veprimit për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Dokumentacioni nuk është kompletuar, duhet të kompletohet nga drejtorit përkatëse.

Këtë draft e ka hartuar Z.K.K.

Drejtorit komunale duhet të jepin kontribut për këtë draft, përfshirë arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, banimin dhe strehimin për të kthyerit.

**Jeton Lika** - Kemi pasur në vitin e kaluar, kemi organizu takim me drejtorit përkatëse, OJQ-ve, është dorëzu, mirëpo ka mbetur ky dokument i pa implementuar, 4 komuna në regionin e Gjilanit e kanë për obligim në bazë të strategjisë të implementohen.

**Kryesues i Komitetit për komunitete Osman Emini** – Isha në një takim në Prizren, ata marrin mëditje me rregullë fikse, ne qe 4 muaj nuk kemi marr.

Të koordino hemi me nënkyetarin e Komunës për të parë se si është puna.

**Jeton Lika** – Është problemi i të gjithë Komiteteve të gjitha komunave.


**Nënkyetari i Komunës Lulzim Aliu** - E kemi diskutu në zyrën e personelit, ku është ba Ligji i pagave, nuk e kanë konsideru si pagë, është problem për krejtë komitetet.

Po e marr përsipër të interesohem.

Ka ardhë një letër që të mos paguhet asnjë mëditje për shkak të buxhetit, shohim për pagesa nga shërbime dhe mallra.

Z.K.K. të takoi Nënkyetarin e komunës për Planin e veprimit s'bashku me Kryesuesin e KK-së për avancimin e planit drejt implementimit.

Procesmbajtës



Xhemajl Jashari

Kryesuesi i Komitetit për komunitete

Osman Emini

